

Data30.06.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "FV ELEKTROPOMPA PER STP".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT CPV:

Pompa centrifugale

REF-91821-06-30-2026

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.800.000 (nje milion e tetqind mije) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”**Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster sh.a**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Te kete objektin e prokurimit te pasqyruar ne veprimtarine e tij sipas Ekstraktit te QKB

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3(tre)viteve të fundit (2023,2024,2025), lëshuar nga Administrata Tatimore ku Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e përlllogaritur të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) gjendjen ekonomike dhe financiare; ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, paragrafi 1 dhe 2 germa “b”, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

Furnizime ne nje vlere se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas DST, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jene të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Te disponoje Licence NS 20 A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në

Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të sherbimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Pikat e licensave janë përcaktuar në baze të zërave të pershkruara në preventivin e projektit. Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

2.3.3 Te kete te punesuar nje staf prej 8 persona per 2 muajt e fundit te deklaruar ne listpagesat Mars ,Prill 2026

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 40 , pika 5/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, numer i konsideruar i mjaftueshem per kryerhen e sherbimeve te larjes, testimit dhe montimit te pompave

2.3.4. Te kete drejtues teknik I inxhinier gjeolog (per larje dhe testim pusi)

Per inxhinierin kerkohet diplome , kontrate e punes e vlefshme dhe emri i tij te jete listpagesat Mars ,Prill 2026

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, gërma “b”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe lloji I sherbimit per pusin ne Fushe Preze. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.5 Operatori ekonomik te disponoje ISO 9001:2015; 14001 :2015;45001-2018 ose variantet e perditesuara te tyre.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 8. Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise), e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

-Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit)**, e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **-ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **ISO 45001-2018** ekuivalente, e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).

Kjo Certifikatë është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.6 Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me numrin e referencës te procedurës së prokurimit. Në rast se në procedurë do të paraqitet vete prodhuesi ose distributori kriteri i parashikuar me lart nuk do të merret i mireqene në ofertat perkatëse. (Preferohet që

fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës)

-Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vertetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentim :ky kriter vendoset pasi provon vijueshmërinë dhe besueshmërinë e OE në fushën e prokurimit,pasi ky OE rezulton të jetë klient i vazhdueshëm për mallrat objekt prokurimit. Kriteri i vlerësimit nga AK është oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim. Kjo nuk pengon asnjë OE të paraqesë të dhëna për mallrat objekt prokurimi që nuk janë prodhuar në vendet e BE apo SHBA, por që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara dhe ofrojnë cilësi sipas standarteve të BE. Nga ana e AK është përcaktuar fjala “preferohet” çka nuk tregon detyrim për vendin e origjinës së mallit.Për këtë arsye AK nuk ka përcaktuar detyrimisht se është e detyrueshme që fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës”ose “fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës”sepse do të ndodheshim në kushtet e parashikuara nga nenin 3/2 të Ligjit 162/2020,ndryshuar kur është përcaktuar vendi i prodhimit të mallit , duke cënuar konkurrencën. Sikundër u sqarua më lart ky paragraf nuk ndikon në vlerësimin e ofertave dhe as në origjinën e mallit që do të ofrohet nga çdo OE për sa kohë ky mall (pavarësisht ku është prodhuar) plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe garanton cilësi të lartë.

2.3.7 Deklarata OE e konformitetit për pompën dhe për motorin elektrik zhytes ku te paraqitet vendi i prodhimit;pershtatshmeria e produkteve dhe elementeve per prodhimin e ujit te pijshem per pompen dhe elektromotorin;elektromotori te jete prodhuar sipas dispozitave te Direktives CE 2014/35;elektromotorat minimumi te jene sandartit IE4.

Shenim:Kriteri i mesiperme pranohet ne forme vetedeklarimi vetem ne momentin e paraqitjes se ofertave.Ne rast te shpalljes fitues duhet te dorezohen ne formen e kerkuar nga ligji prane AK :

Certifikata e përshtatshmërisë për ujë të pijshëm të pompave dhe motorëve elektrikë. Certifikatat duhet të lëshohen nga organet e mëposhtme evropiane të pavarura:

-ACS– Vërtetim de Konformite Sanitaire - Francë

a Ministër i Sante - Drejtimi i Përgjithshëm i Sante DGS / SD7A N 571 i 11/2002

b)-DM 174 - Dekreti Ministror nr. 174 i datës 06/04/2007 përcakton kërkesat e materialeve të destinuara për t'u përdorur në kontakt me ujin e pijshëm - Itali

c Rregullorja sektoriale për lëshimin e certifikimit të cilësisë higjienike, Direktiva TIFQ BRE n.04 (ne perputhje me dokumentin normativ ICIM)

ose ekuivalent (ne perputhje me standartet e BE)

-Certifikate per elektromotoret (Low Voltrage Directive sipas dispozitave te Direktives CE 2014/35)

2.3.8 Deklarate e OE qe elektropompat do te shoqerohen me rezultate zyrtare te testimit dhe qe jane te gatshme te hidhen ne treg.

Shenim:Kriteri i mesiperperm pranohet ne forme vetedeklarimi vetem ne momentin e paraqitjes se ofertave.Ne rast te shpalljes fitues duhet te dorezohen ne formen e kerkuar nga ligji prane AK dokumentat e testimit te pompave

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet qe te vetedeklaroje qe prodhuesi ka certifikime ISO :9001-2015 ; ISO 14001-2015 dhe ISO 45001 :2018 ose sipas Standartit Shqiptar SSH EN ISO :9001-2015 ; SSH EN ISO 14001-2015 dhe SSH EN ISO 45001 :2018 ose ekuivalentet e tyre

Shenim :ne momentin e dorezimit te paraqese ne formen e kerkuar nga ligji certifikatat EN ISO :9001-2015 ; EN ISO 14001-2015 dhe EN ISO 45001 :2018 te prodhuesit ose ekuivalentet e tyre.

2.3.10 Deklarata OE e konformitetit për pompën dhe për motorin elektrik zhytes, shoqeruar me Certifikata e kalibrimit të instrumentit të laboratorit të testimit të prodhuesit (matës të rrjedhës, manometra, vakum metraWatt-metro, etj.), Nga një kalibrim i fundit nga institutet anëtare të "Europeanco-operation for Accreditation" (EA) ose ekuivalent.

Shenim :ne momentin e dorezimit te paraqese ne formen e kerkuar nga ligji certifikatat Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021,ndryshuar neni 40,pika 6,gërma b dhe c)"Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshmi për rezultatet e testimave zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.c) fotografitë apo katalogët teknikë

Argumentimi: Ky kriter vendost për arsye se malli objekt prokurimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment për tu vendosur në punë dhe se duhet të jepet garancia që është provuar dhe testuar duke përmesur dhe specifikimet e kërkuara .Kjo kërkesë ka si qëllim garantimin e Autoritetit Kontraktor për testimet e kryera për mallin që do të furnizohet,pasi nga malli objekt prokurimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment për tu vendosur në punë pas përfundimit të ekzekutimit të kontratës. Në lidhje me institucionin që do të lëshojë certifikatën e kalibrimit. Në lidhje me përcaktimin e "Europeanco-operation for Accreditation" (EA) nga Shkurti 2021 anëtare është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA Albania).

Argumentim:Në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO 9001-2015 ; 14001-2015 dhe 45001-2018 të prodhuesit në momentin e dorëzimit të mallit sqarojmë paraprakisht se ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë cilësinë dhe uljen e rrezikut per blesin perfundimtar AK per shkak te çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga prodhuesi/furnizuesi, përshtatshmërinë e cilesine burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve

dhe ndermarrjen e veprime korrigjuese. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij

Në kushtet kur malli objekt prokurimi është i një rëndësie të vecantë pasi do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë detyrimisht që për arsyet e lartpërmendura për certifikatat ISO kërkohet që ky dokument të zotërohet dhe nga prodhuesi i mallit. Duke qenë të qartë (duke studiuar dhe tregun vendas) që në Shqipëri nuk ka prodhues të pompave të ujit dhe elektromotorëve dhe ky mall vjen nga importi, pavarësisht se kjo kërkesë nëpërmjet OE fitues i drejtohet një pale tjetër (prodhuesit) jo vetëm që garanton cilësinë e mallit të prodhuar, por dhe për arsye të tjera që nuk varen nga AK ose OE fitohet kohë duke u shmangur verifikimi i të dhënave të prodhuesit nga AK. Gjithashtu kërkimi i certifikatave të cilësisë siç u përmend ka të bëjë me mallin objekt prokurimi, rëndësinë e tij duke qenë i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe të provohet fakti që janë të përshtatshme për kontaktin me ujin e pijshëm .

3 Në lidhje me përcaktimin “Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet e mëposhtme evropiane të pavarura“ qëllimi i AK ka qenë që dokumentacioni i kërkuar të lëshohet nga një institucion i pavarur që nuk ka lidhje me prodhuesin e mallit. Nga ana e AK është përcaktuar dhe termi “ekuivalent” ,çka nënkupton se dokumentacioni mund të vijë nga cilido institucion kombëtar apo ndërkombëtar që nuk është i lidhur me prodhuesin.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik datasheet të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi ku të pasqyrohet që rendimenti i eficiences së elektropompës /ve të jete jo me pak si me poshte :

Pompat të kete eficence (η) minimumi 80% dhe elektromotori të jete IE 4.

Te paraqiten me kurbe në grafikun e të dhënave teknike (Technical data sheet)

Baza ligjore (VKM nr.285, datë 19,05,2021, ndryshuar nëni 40, pika 6, gërma b dhe c) Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.c) fotografitë apo katalogët teknikë

Argumentimi: Ky kriter vendoset për arsye se malli objekt prokurimi duhet të permbushë specifikimet teknike të kërkuar dhe dëshmi për këto janë të dhënat teknike data sheet

2.3.12 Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për inverterat.

-Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentim : ky kriter vendoset pasi provon vijueshmërinë dhe besueshmërinë e OE në fushën e prokurimit, pasi ky OE rezulton të jetë klient i vazhdueshëm për mallrat objekt prokurimit. Kriteri i

vlerësimin nga AK është oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim. Kjo nuk pengon asnjë OE të paraqesë të dhëna për mallrat objekt prokurimi që nuk janë prodhuar në vendet e BE apo SHBA, por që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara dhe ofrojnë cilësi sipas standarteve të BE. Nga ana e AK është përcaktuar fjala “preferohet” çka nuk tregon detyrim për vendin e origjinës së mallit. Për këtë arsye AK nuk ka përcaktuar detyrimisht se është e detyrueshme që fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës”ose “fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës”sepse do të ndodheshim në kushtet e parashikuara nga nenin 3/2 të Ligjit 162/2020, ndryshuar kur është përcaktuar vendi i prodhimit të mallit, duke cënuar konkurrencën. Sikundër u sqarua më lart ky paragraf nuk ndikon në vlerësimin e ofertave dhe as në origjinën e mallit që do të ofrohet nga çdo OE për sa kohë ky mall (pavarësisht ku është prodhuar) plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe garanton cilësi të lartë.

2.3.13 Operatori Ekonomik të paraqite deklaratë që prodhuesi zoteron ISO :9001-2015 dhe certifikim sipas dispozitave të Direktives CE 2014/35.

Shenim: OE duhet që në momentin e dorëzimit të paraqesë certifikatat ISO :9001-2015 të prodhuesit, dhe për standartin sipas dispozitave të Direktives CE 2014/35, në formën e kërkuar nga ligji

Baza ligjore (VKM nr.285, datë 19,05,2021, ndryshuar neni 40, pika 6, gërma b dhe c) "Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.c) fotografitë apo katalogët teknikë

Argumentimi: Ky kriter vendost për arsye se malli objekt prokurimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment për tu vendosur në punë dhe se duhet të jepet garancia që është provuar dhe testuar duke përmbushur dhe specifikimet e kërkuara. Kjo kërkesë ka si qëllim garantimin e Autoritetit Kontraktor për testimet e kryera për mallin që do të furnizohet, pasi nga malli objekt prokurimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment për tu vendosur në punë pas përfundimit të ekzekutimit të kontratës. Në lidhje me institucionin që do të lëshojë certifikatën e kalibrimit. Në lidhje me përcaktimin e "Europeanco-operation for Accreditation" (EA) nga Shkurti 2021 anëtare është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA Albania).

Argumentim: Në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO 9001-2015 ; 14001-2015 dhe 45001-2018 të prodhuesit në momentin e dorëzimit të mallit sqarohet paraprakisht se ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë cilësinë dhe uljen e rrezikut për blesin e prodhimit AK për shkak të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga prodhuesi/furnizuesi, përshtatshmërinë e cilësive burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin e shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizajnimin e produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve dhe ndermarrjen e veprimeve korrigjuese. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij

2.3.14 Mjete

<i>Nr</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Autosonde per zhbllokimin e mbetjeve te aluvioneve te pusit dhe uljen dhe ngritjen e tubave te solucionit</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
2	<i>Kompresor per futjen me presion te ajrit dhe solucionit ne pus</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
3	<i>Elektropompe zhytese H=150 m, Q=35 l/sek e pajisur me inverter me fuqi P=75 Kw (Elektropompat sherbejne per te matur sasine minimale dhe maksimale te ujit ne pus. Paneli Inverter sherben per t'ju pershtatur sasise te ujit qe do jape pusi)</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
4	<i>Mates uji elektromekanik me fllanxa Dn 250 mm me dalje (4-20mA) Matesat e ujit duhen elektromekanik per te matur ujin me saktesi dhe per te hedhur te dhenat ne kompjuter(Laptop</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
5	<i>Aparat me matje diagrame per te matur uljen e nivelit te ujit ne pus dhe per ta lidhur me kompjuterin(Laptopin)</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
6	<i>Kompjuter ose (Laptop) per te nxjerre kurben dhe per te percaktuar sasine(Q) dhe thellesine(H) te ujit ne pus</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
7	<i>Kamion me vinc 10 Ton minimumi</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
8	<i>Kamiocine deri 3.5 ton</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>
9	<i>Kamiocine me vinc deri me 3.5 ton</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>	<i>1</i>

Shenim: Per mjetet ne momentin e ofertimit te plotesohet formulari i vetedeklarimit .Ne rast te shpalljes fitues OE do te paraqite dokumentacionin ne formen e kerkuar nga ligji dhe te shoqeruar me fotografi .

Për mjetet të paraqiten dokumentat e pronësise(fatura blerje ,zhdoganimi etj, ndërsa për sondën lejë qarkullimi,akt kolaudimi dhe siguracion). Në rast të kontratave të qirasë krahas dokumentave të mësipërm të paraqiten dhe kontratat e qirase te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Ne rast se kontrata e qirase perfundon perpara apo brenda afatit te zbatimit te kontrates se lidhur me AK, Kontraktori do te lidhe nje kontrate te re dhe do ta paraqite para AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 8” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar . Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Afatet e lëvrimit: 5 dite pune

Nr	EMERTIMI I MATERIALEVE	Njesia	Sasia
1	FV.Elektropompe horizontale, H=150 m,Q=90 m3/ore	Cope	1
2	FV.Elektropompe zhytes, H=10 m,Q=90 m3/ore	Cope	1
3	FV.Panel komandimi me Inverter,P=90 kw.	Cope	1
4	FV.Panel komandimi me Inverter,P=5.5 kw.	Cope	1
5	FV.Mates uji Elektromagnetik,Dn150mm,Pn16.	Cope	1
6	FV.Monometer me fushe te madhe me glicerine,Pn25.	Cope	1
7	Larje pusi me ajer dhe solucion	ore	4
8	Testim Pusi	ore	24
	SHUMA B		
	TVSH 20%		
	Totali me tvsh		

NJËSIA E PROKURIMIT